




Në Raportin e Ndikimit të këtij viti e kemi ndryshuar qasjen dhe e kemi përqendruar rrëfimin tonë të qëndrueshmërisë në pesë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm që përshkruajnë më së miri rezultatet e aktiviteteve tona. Fokusi kryesor është në këto katër tema:



1. Vendet e punës dhe investimet: Fuqizimi i komuniteteve, krijimi i mundësive



Në ProCredit, ne po sjellim ndryshim përmes:

- Ndryshimit pozitiv:** Me krenari mbështesim mbi **34,000 NMVM**, të cilat përbëjnë shtyllën kurrizore të ekonomive tona lokale.
- Dekarbonizimi:** Mbi 20% e portofolit tonë mbështet eficiencën e energjisë, energjinë e ripërtërishme dhe nismat ekologjike. **Synimi ynë afatmesëm është ta rrisim këtë përqindje në 25%.**
- Energji e pastër:** Kemi financuar kapacitet të instaluar prej **859 MWp** në projekte fotovoltaike, duke kontribuar drejtpërdrejt në tranzicionin e qëndrueshëm energjetik në vendet ku operojmë.
- Barazia gjinore:** Përmes pjesëmarrjes në **nismën 2X Global**, kemi rritur mbështetjen për bizneset në pronësi të grave. Në vitin 2023, mbi **20%** e kredive tona për NMVM i kanë mbështetur drejtpërdrejt kompanitë **me 50% ose më shumë në pronësi të grave.**

- Furnitorë të qëndrueshëm:** Ne kemi vlerësuar 90% të furnitorëve tanë duke përdorur udhëzuesit e qëndrueshmërisë në nivel grupi. **40%** e tyre i plotësuan me sukses kriteret tona të rrepta.

Portofoli ynë i kredive ka krijuar **193,344** vende pune. **42%** e këtyre vendeve të punës fuqizojnë gratë dhe **7%** e luftojnë ikjen e trurit që prek të rinjtë në shoqëritë tona.

2. Diversiteti dhe gjithëpërfshirja

Fuqizimi i ekipit tonë, nxitja e përfshirjes



Ne e kemi përcaktuar **Planin e Veprimit Gjnor**

për të forcuar dhe strukturuar mbështetjen tonë në fuqizimin e grave.

Në bankën ProCredit, ekipi ynë është forca lëvizëse prapa rrugëtimit tonë drejt qëndrueshmërisë:

- **Investimi në njerëz:** Kemi investuar rreth **9.4 milionë EUR** në trajnime, që përkthehet në **114 orë** trajnimi për çdo punonjës.
- **Trajnim për Kodin e Sjelljes:** Çdo punonjës ka vijuar trajnimin e plotë për Kodin e Sjelljes gjatë vitit 2023, me gjithsej mbi **21,600 orë** mësimi.
- **Diversiteti dhe gjithëpërfshirja:** Duke filluar nga viti 2024, do të zhvillojmë rregullisht seanca trajnimi për diversitetin dhe gjithëpërfshirjen.
- Mbi 81,000 gra janë mbështetur përmes vendeve të punës të krijuara nga klientët tanë NMVM.

3. Dekarbonizimi: Duke filluar nga operacionet tona



- **Parku diellor ProEnergy:** Ky projekt do të prodhojë **3,711 MWh** në vit, që është e barabartë me konsumin e energjisë elektrike nga rreth **500 familje**.
- **Përdorimi i energjisë së pastër:** Nëntë institucione ProCredit kanë instaluar sisteme fotovoltaike në çatitë e tyre, me një **kapacitet të përbashkët të instaluar prej 466 kWp**.
- **Veturat elektrike:** Flota jonë e automjeteve përbëhet tashmë nga **61% vetura hibrid dhe makina elektrike**, ndërsa një vit më parë ishte 52%.
- **Certifikimi i ndërtesave të gjelbra EDGE:** Zyra qendrore e Bankës ProCredit Ukrainë në Kiev u vlerësua me certifikimin e ndërtesës së gjelbër EDGE. Me këtë arritje, numri i përgjithshëm i zyrave qendrore të bankave ProCredit me këtë certifikim prestigjioz ka arritur në gjashtë.
- **Zero mbetje:** Ne e mbajmë në **100% shkallën e riciklimit** për letrën dhe mbetjet elektronike.

Kemi inauguruar parkun tonë diellor **ProEnergy** në Kosovë.

4. Veprimi klimatik: Angazhimi neto-zero i bankës ProCredit



Kemi vërtetuar caqet tona afatshkurtra për arritjen e emetimeve neto-zero me SBTi dhe kjo është rruga jonë:

- **Deri në vitin 2030,** synojmë të ulim emetimet tona vetanake (Fushëveprimi 1 dhe 2) me 42% (duke pasur vitin 2022 si bazë), përmes **rritjes së përdorimit të energjisë së ripërtëritshme dhe automjeteve elektrike**.
- **Dekarbonizimi i fokusuar te klientët:** Synimi ynë për Fushëveprimin 3, për vitin 2027, është të **angazhohemi me klientët NMVM** që përfaqësojnë 28% të emetimeve të portofolit të

grupit, me theks te sektori i bujqësisë dhe ai prodhues. Përveç kësaj, zotimi ynë përfshin edhe vazhdimin e financimit vetëm të projekteve energjetike që mbështeten në burime të ripërtëritshme.

Financimi i projektit tonë të energjisë përbëhet tërësisht nga **projekte të energjisë së ripërtëritshme**.

1. Vendet e punës dhe investimet: Fuqizimi i komuniteteve, krijimi i mundësive



- **Ndryshim pozitiv:** Në Kosovë, mbështeten **2302 NMVM**, të cilat konsiderohen si shtylla kurrizore e ekonomisë lokale.
- **Dekarbonizimi:** 15.6% e kredive tona janë kredi të gjelbra dhe kemi një pjesëmarrje prej **21% të kredive investuese të gjelbra**, të cilat mbështesin projekte të efikasitetit energjetik, energji të ripërtëritshme dhe projekte miqësore ndaj mjedisit nga portofoli i përgjithshëm i kredive/investimeve. Synimi afatmesëm i bankës ProCredit, si institucion, është ta rrisë këtë përqindje në 25%.
- **Energji e pastër:** Në Kosovë kemi financuar **29.4 MWp** kapacitet të instaluar në projekte fotovoltaike që kontribuojnë në tranzicionin e qëndrueshëm energjetik.
- **Drejtësia gjinore:** Banka ProCredit ka forcuar mbështetjen për bizneset në pronësi të grave. Në vitin 2023, 9% e kredive tona NMVM u janë dhënë drejtpërdrejt kompanive me **50% ose më shumë në pronësi të grave**.
- **Furnitorë të qëndrueshëm:** Ne kemi vlerësuar 100% të furnitorëve tanë duke përdorur udhëzuesit e qëndrueshmërisë në nivel grupi. 53% e tyre i plotësuan me sukses kriteret tona të rrepta.

Në dhjetor 2023,
Banka ProCredit në Kosovë,
**mbështet 8457 vende
pune,**
41% e këtyre
vendeve
fuqizojnë gratë.

2. DIVERSITETI DHE GJITHËPËRFSHIRJA Fuqizimi i ekipit tonë, nxitja e përfshirjes.



Kemi përcaktuar planin tonë të parë të veprimit gjinor për të forcuar dhe strukturuar mbështetjen tonë për **fuqizimin e grave**.

Në bankën ProCredit, ekipi ynë është forca lëvizëse prapa rrugëtimit tonë drejt qëndrueshmërisë:

- **Investimi në njerëz:** Gjatë vitit 2023 kemi investuar rreth **770,000 EUR** në trajnime, që përkthehen në **60,000 orë** trajnimi për stafin e ProCredit, ose **200 orë trajnimi** për secilin punonjës.
- **Trajnim për Kodin e Sjelljes:** Çdo punonjës ka vijuar trajnimin e plotë për Kodin e Sjelljes dhe për aspekte mjedisore gjatë vitit 2023, me një total prej **10,000 orësh**. Të paktën një herë në vit mbahet një trajnim në temat sociale për të gjithë punonjësit.
- **Diversiteti dhe gjithëpërfshirja:** Meqë edhe diversiteti dhe gjithëpërfshirja janë tema sociale, së paku një herë në vit është e detyrueshme një seancë trajnimi për të gjithë punonjësit.

3. Dekarbonizimi: Duke filluar nga operacionet tona



- **Parku diellor ProEnergy:** Kemi inauguruar parkun tonë diellor ProEnergy në Kosovë. Ky projekt do të prodhojë **3,711 MWh** çdo vit, e barasvlershme me konsumin e energjisë elektrike të rreth 500 familjeve.
- **Përdorimi i energjisë së pastër:** Në bankën ProCredit të Kosovës, kapaciteti i instaluar i sistemit fotovoltaike në çati është **39.4 kWp**.
- **Veturat elektrike:** Aktualisht, 61% e flotës sonë të automjeteve përbëhet nga vetura hibride dhe makina elektrike. Objektivi i bankës ProCredit për automjetet është të arrijmë 100% vetura elektrike deri në vitin 2027.
- **Certifikimi i ndërtesës së gjelbër EDGE:** Banka ProCredit e Kosovës është vlerësuar me certifikimin e ndërtesës së gjelbër EDGE. Jemi banka e parë në Kosovë që merr një certifikim të tillë.
- **Zero mbetje:** Shkallën e riciklimit të letrës e kemi **100%**.

Kemi inauguruar parkun
tonë diellor ProEnergy
në Kosovë.